



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 5, datë 26.01.2021

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “SHTESË E IMPIANTIT TË PËRPUNIMIT TË UJIT TË PIJSHËM BOVILLË ME 1800 L/SEK, NË FAZËN E DYTË TË ZBATIMIT ME 1200 L/SEK”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË DHE BASHKINË KAMËZ


Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” sh.a., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:


1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Shtesë e impiantit të përpunimit të ujit të pijshëm Bovillë me 1800 l/sek, në fazën e dytë të zbatimit me 1200 l/sek”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë dhe Bashkinë Kamëz, me zhvillues shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor.
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë dhe Bashkisë Kamëz.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
LEDIA TOTA

